



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

## FTESË PËR OFERTIM

DHËNIEN ME QERA PËR MENAGJIM TË VENDIT PËR GJUETI TË PËRBASHKËT  
“LIPJANI LINDJE” LLOT 1 DHE LIPJANI PËRËNDIM” – LLOT 2

**Numri referues i shitjes:** 14-324-61029

**Datë** 01/12/2017

### NENI I: EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

|                                                           |                                |
|-----------------------------------------------------------|--------------------------------|
| <b>Emri zyrtar:</b>                                       |                                |
| <b>Adresa e AK:</b> KOMUNA E LIPJANIT , rr “Shqipëra” p.n |                                |
| Qyteti: LIPJAN                                            | Kodi postar:14000              |
| URL (nëse aplikohet):                                     |                                |
| <b>Personi kontaktues:</b> Adem Duriqi<br>Daut Reçica     | E-mail:daut.reçica@rks-gov.net |
| Telefoni: 038 200 415 39                                  | Faksi:                         |

### NENI II: LËNDA E SHITJES

Autoriteti kontraktues ka për qëllim dhënien me qera për menagjim të vendit për gjueti të përbashkët “Lipjani lindje” Llot1 dhe Lipjani Përëndim” – Llot 2 për 10 vite përmes ofertave publike të mbyllura.

Kontraktuesi obligohet që:

- **Ruajtjen, kultivimin dhe shtimin i faunës në komunën e Lipjanit,**
- **Gjuetia e tyre të ketë karakter më tepër për rekreacion,**
- **Ndalimi i gjuetisë për llojin e caktuar, që është në rrezik të zhdukjes apo zvogëlimit në masë të caktuar.**

**Kontraktuesi, do të paguaj qiranë vjetore (çmimi minimal për marrjen me qera të vendit për gjueti në komunën e Lipjanit ) Lipjani lindje llot 1 shumën prej 9377.50 € .dhe Lipjani perëndim llot 2 shumën prej 7120.00€**

**Kontraktuesi, është i obliguar t’i përmbahet me përpikëri Ligjit mbi Gjuetinë në Republikën e Kosovës dhe udhëzimeve tjera që nxirren në bazë të këtij ligji - shiten në kushte “siç janë, ku janë” .**

### NENI III: INFORMATA ADMINISTRATIVE

Autoriteti Kontraktues, fton që me oferta të mbyllura të ofertojnë, për dhënien me qera për menaxhim të vendit për gjueti të përbashkët.

**Shënimet e përgjithshme të vendit për gjueti si dhe emërtimi dhe përshkrimi i kufijve të saj.**

**Linja kufitare e vendit për gjueti të përbashkët “Lipjani-lindje”** në sipërfaqe prej 11677.73, e cila kufizohet me: Autostradën “Arbër Xhaferi”, duke filluar nga fshati Dobratin - Kumuna Graqanicës, për të vazhduar përgjatë saj deri në fshatin Babush i Muhaxherëve. Vazhdon përgjatë kufirit administrativ me Komunën e Ferizajit dhe Zonës kadastrale të fshatit Babush i Muhaxherëve që lidhet në vazhdim me zonën kadastrale Gadime e Ulët dhe Gadime e Epërme.

Vazhdojnë Zonat Kadastrale: Vrellë e Gadimes, Plitkoviqit, Sllovisë, Akllapit, Vogaqicës dhe Brusit përgjatë kufirit administrative me Komunën e Gjilanit. Zona kadastrale e Brusit vazhdon përgjatë kufirit administrativ me Komunën e Novo Bërdës dhe Komunës së Prishtinës. Pas saj vjen Zona kadastrale e Hanrovcit e cila kufizohet me kufijt administrative të Komunës së Prishtinës kurse Zona Kadastrale e Okosnices kufizohet me Kufijt administrativ të Komunas së Prishtinës dhe Graqanicës. Zona Kadastrale e Janjevës kufizohet me kufijt administrative të komunes së Prishtinës për të vazhduar me Zonën Kadastrale të Teqes e cila kufizohet me kufijt administrativ të Komunes së Prishtinës dhe Graqanicës. Vazhdojnë Zonat Kadastrale të Janjevës, Akllapit, Sllovisë dhe Smallushës të cilat kufizohen me kufijt administrative të Komunes së Graqanicës e cila bashkohet me pikën fillestare në Autostradën “Arbër Xhaferi”.

**Linja kufitare e vendgjuetisë së përbashkët “Lipjani-perëndim”** në sipërfaqe prej 12146.29ha, e cila kufizohet:

Fillon përgjatë kufirit administrativ të Komunës së Graqanicës me Zonat kadastrale: Livagjë dhe Gushtericë e poshtme për të vazhduar përgjatë Autostradës “Arbër Xhaferi” deri në fshatin Babush i Muhaxherëve. Vazhdon përgjatë kufirit administrativ me Komunën e Ferizajit dhe Zonës kadastrale të fshatit Babush i serbëve që lidhet në vazhdim me zonën kadastrale Bablak dhe Tërn. Vazhdon përgjatë kufirit administrativ me Komunën e Shtimes me Zonat kadastrale: Vojnovc, Muzeqinë, Gjurmoc, Godanc i Epërm, Zborc, Pjetërshticë dhe Karaqicë. Vazhdon përgjatë kufirit administrativ me Komunën e Suharekës me Zonën kadastrale të Javorit. Vazhdon përgjatë kufirit administrativ të Komunës së Malishëvës me Zonat kadastrale: Lladroc, Senikë, Lladroviq dhe Tërpezë. Tutje kufizohet përgjatë kufirit administrativ të Komunës së Glllogocit me Zonat kadastrale: Nekocë, Fushticë e Poshtme, Fushticë e Epërme dhe Sankoc. Vazhdon përgjatë kufirit administrativ të Komunës së Fushë Kosovës me zonat kadastrale: Harilaq, Sllatinë e Madhe dhe Hencë. Vazhdon përgjatë kufirit Administrativ të Komunës së Graqanicës me Zonat Kadastrale: Radevë, Lepi, Skallanë dhe përfundon me Zonën kadastrale të Suhadollit për t'u bashkuar me pikën fillestare.

**Afati i dhënies në shfrytëzim është në kohëzgjatje prej: 10 vitesh nga data e nënshkrimit të kontratës**

Autoriteti Kontraktues fton oferta të mbyllura për dhënien me qera

**[Ofertimi është i hapur për të gjithë ofertuesit e interesuar] Të drejtë pjesëmarrje në këtë ofertë kanë të gjithë personat fizik dhe juridik:** Personat Fizik dhe Juridik, krahas aplikacionit, në kuvertë duhet të ofrojnë edhe dokumentet të cilat janë të specifikuar në Dosjen e Ankandit.

Dokumentet e ofertimit do të kërkohen nga ofertuesit e interesuar duke dorëzuar një aplikacion me shkrim në adresën e cekur më lartë.

Dokumentet e ofertimit do të kërkohen nga ofertuesit e interesuar duke dorëzuar një aplikacion me shkrim në adresën e cekur më lartë.

**Personat fizik:**

1. **Kopje e Letër Njoftimit**
2. **Dëshmi nga gjykata se personi përgjegjës nuk është i dënuar ose i ndjekur për vepër penale**
3. **Dëshmi mbi pagesën e tatimit në prone për periudhën e parë 2017.**
4. **Deklarata nën betim** – e nënshkruar (ky dokument është pjesë e ofertës)

**Persona Juridik:**

1. **(1.1.) Dëshmia e regjistrimit të veprimtarisë,**
2. **(1.6.) Dëshmi nga gjykata se personi përgjegjës nuk është i dënuar ose i ndjekur për vepër penale,**
3. **(1.7.) Dëshmi që vërtetohet se nuk ka obligime financiare ndaj Agjencisë Tatimore të Kosovës,**
4. **Vërtetimin e Tatimit në Prone për periudhën e parë 2017 (jo më e vjetër se një muaj)**

**Deklarata nën betim** – e nënshkruar dhe e vulosur (ky dokument është pjesë e ofertës)

Ofertuesit e interesuar mund të inspektojnë vendin për gjueti të përbashkët “Lipjani lindje” dhe “Lipjani Perendim” që nga momenti i hapjes së ankandit deri në momentin e dorëzimit të dokumenteve për ankand

Ofertat duhet të **dorëzohen në zarfe të mbyllur në zyrën e prokurimit në Komunën e Lipjanit, rr. “Shqipëria” p.n, me datë 10/01/2018 deri në ora: 14:00h.**

Ofertat do të hapen në prezencë të përfaqësuesve të ofertuesve të cilët dëshirojnë të marrin pjesë në adresën e cekur më lartë në

- **hapja në zyrën e prokurimit në Komunën e Lipjanit, rr. “Shqipëria” p.n, me datë 10/01/2018 deri në ora: 14:00h.**

Ofertat e vonuara do të refuzohen.

Dhënia e kontratës: ***Çmim ekonomikisht me i favoreshëm***

**Oferta Ekonomikisht më e favorshme:**

- 1.2. **Dëshmi mbi përvojën e punës në menaxhimin me kafshë të egra dhe gjueti (kjo vlen për menaxhuesit e gjertanishëm me gjueti – shoqatat e gjuetisë) nga Federata e Gjahtarëve të Kosovës, si dhe përshkrimin e rezultateve menaxhuese nga vitet paraprake.....10 %**

**Dëshmi certifikata nga Shoqata e gjuetarve**

- 1.3. Dëshmi mbi përvojën e punës në menaxhim dhe rezultatet e arritura në veprimtari të ngjashme – për subjektet tjera juridike dhe fizike si në: pylltari, bujqësi, veterinë, turizëm, ekologji.....10 %**
- 1.4. Dëshmi certifikata të ndryshme nga organizatat të ndryshme që kanë të bëjnë me ruajtjen e florës dhe faunës**
- 1.5. Dëshmi për shërbime profesional që do të angazhohet në menaxhim, duke përfshirë numrin e të punësuarve – gjuetarë të kualifikuar, roje gjuetie, profesionistë të florës dhe faunës.....10 % minimumi 10 punëtorë**
- Dëshmi, kontrata ose parakontrata për 10 punëtorë**
- 1.6. Programin për synimet e menaxhimit dhe zhvillimit të vendit për gjueti – mbrojtja, ruajtja, kultivimi dhe shtimi i kafshëve të egra.....10 %**
- Dëshmi, programi i hartuar për menaxhimin e vendit për gjueti**
- 1.7 Dëshmi për posedimin e mjaftueshëm të mjeteve financiare për ushtrimin e kësaj veprimtarie minimumi 10000€ në llogari ose dëshmi nga ndonjë bankë se do ta financojë këtë veprimtari.....10 %**
- Çmimi më i lartë i ofertës për qiranë.....50 %**

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë te Organi Shqyrtues i Prokurimit, sipas dispozitave të Kapitullit IX të Ligjit Nr. 04/L-042, Ligji mbi Prokurimin Publik në Kosovë.